



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA


KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT- Raport vjetor (janar – qershor 2025)



**DREJTORIA E ARSIMIT
NË DEÇAN**



Raporti i punës së Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) paraqitur kryetarit të komunës për muajt (janar – qershor të vitit 2025).

Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë janë realizuar gjatë kësaj periudhe me përkushtim dhe me përgjegjësi të plotë.

Me prezantimin e këtij raporti do të jeni më afër të njohur dhe të informuar sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Deçan.

Procesi arsimor gjatë këtij viti ka qenë vazhdimisht i përcjell me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit.

Kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore.

Janë mbajtur takime të rregullta edhe me MASHTI-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë.

STRUKTURA ORGANIZATIVE - Këtë sektor e përbejnë 6 punëtor:

Drejtori, 1 Udhëheqës sektori administrativ,

1 Udhëheqës i sektorit për arsim,

1 Përgjegjësja për Buxhet dhe Financa

1 Zyrtari për Arsimin e Mesëm të Lartë

1 Zyrtari Ligjor

1 Zyrtari për Arsimin Fillor

- Në menaxhim të komunës janë 20 objekte shkollore të arsimit parauniversitar,
- Deçani ka një Institucion parashkollor (publiko - privat) dhe një privat, në ndërtim e sipër institucioni publik në hapsirën e SHFMU “Lidhja e Prizrenit”
- 18 shkolla fillore dhe të mesme të ultë,(4 paralele të ndara fizike),
- 2 shkolla të mesme të larta,
- Ku punojnë gjithsejtë 567 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt rreth 4809 nxënës. 33 punëtor administrativ, 427 mësimdhënës, 85 punëtor teknik.
- Nuk ka asnjë institucion arsimor të pajisura me sisteme të energjisë solare.
- Nuk ka asnjë institucion arsimor të pajisur me sisteme gjeotermale.
- Janë 15 institucione arsimeore të pajisura me masa për kursimin e energjisë.
- 20 institucione arsimore janë të pajisura me rrethoja të objekteve.
- 20 institucione arsimore janë të pajisura me sisteme të kamerave të sigurisë.
- 10 institucione arsimore janë të pajisura me sallë të edukatës fizike me mjete dhe pajisje,
- 6 institucione arsimore janë të pajisura me kabinete (laboretore, punëtori)

- 15 institucione arsimore janë të pajisura me bibliotekë të shkollës në funksion,
- 18 institucione arsimore janë të pajisura me kabinete të TIK-ut me mjete dhe pajisje në funksion,
- 1 institucion arsimor parauniversitar është e pajisur me një klasë të zakonshme me orendi dhe pajisje të domosdoshme shkollore (klasa e bashkanigjitur në SHFMU “Lidhja e Prizrenit”).

Aktivitetet më të rëndësishme të realizuara :

- Mbledhje të rregullta, dhe takime ditore, javore me drejtorë të institucioneve shkollore janë realizuar në vazhdimësi. Në këto takime është kërkuar angazhim edhe më i madh i mësimdhënësve për ngritjen e cilësisë në arsim, respektim në përpikëri të ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve në fuqi.
- Mbledhje të rregullta me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Vlerësimi i performancës së brendshme dhe të jashtme të shkollave nga vlerësimi i brendshëm (DKA) janë vlerësuar drejtor/e të institucioneve publike të arsimit parauniversitare edhe nga vlerësimi i jashtëm me performancë të shkëlqyer dhe të mirë.
- Pranimi i raporteve të rregullta në baza ditore, javore, mujore, vjetore nga të gjithë drejtorët e shkollave. Interesimi dhe angazhimi i të gjithë akterëve (personelit arsimor, prindërve, nxënësve, stafit mbështetës etj.) ishte qenë në nivel.
- Është realizuar studimi rapid në këtë periudhë i të gjitha shkollave me qëllim të identifikimit të pikave të dobëta në secilën shkolle në mënyrë që të jenë in putë për hartimin e strategjisë së arsimit në nivel komunal
- Në ngritjen e cilësisë së arsimit në përgjithësi ka ngritje dhe kushte më të mira për nxënës dhe personel.
- Deçani tashmë i prinë disa komunave në nivel vendi sa i përket sukseseve në lëndë të ndryshme shkollore, garat komunale dhe ato mbarëkombëtare, edhe këtë vit është vërtetuar ky sukses i nxënësve tonë.
- DKA është vlerësuar nga SIA –MASHTI për zbatueshmërinë e normativit dhe fondit të orëve, ku i prijmë komunave të Kosovës.
- DKA është vlerësuar nga divizioni për ngritje dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve nga MASHTI për suksesin e lartë të arritur dhe prijmë para të gjitha

komunave të Kosovës, nga janari deri në qershor janë trajnuar mbi 350 mësimdhënës në fusha të ndryshme.

- Mbikëqyrja në institucionet edukative arsimore, sipas objektivave të paraparë nga ana e zyrtarëve dhe drejtorit të DKA-së, ku zyrtarët kanë mbështetur stafin e shkollave me këshilla profesionale.
- Përgatitjet dhe organizimi e testeve : të arritshmerisë, maturës shtetërore 2025, testi PIRLS, testi TIMMS, PISA etj.
- Janë realizuar planifikimet për fondin e orëve të klasave me kurrikulën e re dhe zbatimin i udhëzuesit për ndarjen e orëve me zgjedhje.
- Sa i përket realizimit të fondit të orëve si dhe procedurave rekrutuese të konkurseve sipas SIA –MASHTI (regjioni i Pejës) DKA Deçan i prinë të gjitha komunave në regjionin e Pejës.
- Mbajtja e garave komunale në lëndën: matematikë, fizikë duke bashkëpunuar me organizatat në nivel nacional dhe kombëtare.
- Mbajtja e ligjëratave në shkolla nga Policia e Kosovës, lidhur me parandalimin e dukurive negative të nxënësit dhe të rinjtë (ligjëratat me tema specifike janë mbajtur çdo muaj, me fokus grupe).
- Publikimi i konkurseve dhe regjistrimi i fëmijëve si dhe nxënësve në institucionet arsimore si: institucioni parashkollor, dhe në klasat e para.
- Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, gjatë kësaj periudhe ka pasur takime bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku janë shtjelluar tema të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin, mbështetjen dhe avancimin e procesit mësimor dhe reformave në arsim: Ekspert të arsimit nga BE, Fakulteti i Edukimit, përfaqësuesit e GIZ-it, për sa i përket trajnimeve dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve, KFOR-in, Down Syndrom Kosova, OJQ ``Jeta`` etj.
- Në ambientet e Komunës, u organizua takim informues me drejtorët e shkollave fillore të mesme dhe të ulëta: "Heronjtë e Dukagjinit", "Dëshmorët e Baballoqit", IAAP "Tafil Tasumaj", Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri", gjithashtu edhe koordinatoret e këtyre shkollave. Temat që u diskutuan kishin për qëllim informimin për Testin PISA, dhe takime online me koordinatoret e shkollave. Temat i shtjelluan zyrtarët nga MASHTI znj Habibe Buzuki dhe z. Afrim Rrahmani, që procesi të zhvillohet pa pengesa. Temat ishin: konfidencialiteti, informata rreth pyetsorit, mundësitë e qasjes online në pyetsor, target grupet e anketimit. Pjesëmarrës në takim ishin, drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj ku u zotua që gjatë këtij procesi do të angazhohet personalisht në mbarvajtjen e anketimit. Edhe koordinatori komunal z. Zeqë Malaj

isht optimist që anketimi do të zhvillohet sipas parashikimeve, bazuar në kushtet e favorshme që kanë shkollat tona të përgatitura me mjete teknologjike.

- Futja e të dhënave statistikore për numrin e fëmijëve dhe personelit, në sistemin EMIS-MAShTI.
- Në mënyrë të vazhdueshme bëhet integrimi në institucione arsimore dhe trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Në fushën e psikologjisë, me psikologë të shkollave gjatë punës së vazhdueshme profesionale, në vitin 2025 kemi mbajtur puntori për vetëdijesim të nxënësve lidhur me parandalimin e dukurive negative, në të gjitha shkollat kemi mbajtur në formë relative puntori me tema të rëndësishme të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e tyre, si;
1. Bullizmi dhe masat parandaluese, 2. Pasojat e narkotikeve, 3. Dhuna në Familje, 4. Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të Internetit, 5. Parandalimi i ngacmimeve Seksuale dhe masat ndëshkimore ligjore, 6. Respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, 7. Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik, 8. Ruajtja e ambientit dhe e trashëgimisë kulturore.
- Në këtë periudhë kemi pas bashkëpunim me asistent të FAMNV, për të ndihmuar në procesin e mësimin për FAMNV, të asistoj në hartimin e PIA për mësimdhënësit të cilët nuk kanë pasur mundësi të hartojnë këtë plan i cili është mjaft i vështirë si punë fillestare për mësuesit të cilët duhet ta kenë si plan të rregullt për këta fëmijë.
- Gjatë kësaj periudhe kemi trajtuar në aspektin psikologjik rastet të cilat kanë pasur nevojë për këtë trajtim; familjet për fëmijët e vet, institucionet arsimore, QPS.
- Në vazhdimësi janë organizuar punëtori dhe takime me temën: Diskutim rreth detyrave përgjegjëse dhe vështirësive të Asistentëve për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore, gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të tyre. Takimet u organizuan nga koordinatori i Ekipës Komunale për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta z. Ramiz Bajramaj nga DKA, kurse u realizuan nga psikologjia Besarta Tahirukaj-Idrizi dhe Florenta Molliqaj, Magjistër e Edukimit Inkluziv. U diskutuan problematika, vështirësitë që asistentët dhe mësimdhënësit hasin në punën e tyre me fëmijë me nevoja të veçanta po ashtu u shkëmbyen përvoja u dhanë këshilla e sugjerime rreth kësaj pune sa sfiduese dhe e ndjeshme njëkohësisht.
- Për nder të 7 Marsit, ditës së mësuesit, Drejtori i Arsimit, u ndau mirënjohje për mësimdhënësit e komunës së Deçanit.

- Çdo vit me datën 7 Mars në Ditën e Mësuesit, Ministria e Arsimit ndan çmimin “Shaban Jashari” dhe mirënjohje për mësime mësuesit e përkushtuar dhe të dalluar në profesionet e tyre, në mesin e shumë mësime mësuesve të tillë, Drejtoria e Arsimit e ka propozuar mësime mësuesin veteran z. Ahmet Ukaj, e cila mirënjohje u nda në këtë ditë të shënuar.
- Në organizim të DKA-së, u mbajt trajnimi për 43 mësime mësues të shkollave tona. Trajnimi "Zbatimi i kurrikulës së re" e udhëhoqi Dr. Pedagogu Hysen Balaj. Gjatë trajnimit, mësime mësuesit i vizitoj Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, ku i inkurajoj mësime mësuesit që informatat e përfituara në trajnim t'i praktikojnë më nxënësit e tyre, gjithashtu i siguroj ata që trajnime dhe punëtori të tilla do të organizohen edhe në të ardhmen. Trajnimin e ndjekën 43 mësime mësues te të gjitha niveleve.
- Ekipi komunalë për parandalim të braktisjes së shkollës është marr me rastet që kanë pasur tendencë braktisje.
- Drejtoria e Arsimit në Deçan në bashkëpunim më zyrën e kryetarit të komunës ka organizuar festën e Abetares së bashku për të gjitha shkollat e komunës sonë, .
- Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2023 për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, po bëhet vlerësim i fëmijëve. Pas raportit dhe rekomandimeve të marrura nga ky vlerësim drejtoria e shkollës do të merr vendim për regjistrimin e këtyre fëmijëve në klasën e parë.
- DKA ishte në disa shkolla pjesëmarrëse në manifestimin e Ditës së shkollës,
- Bashkë me zyrën e Kryetarit z. Bashkim Ramosaj, janë organizuar takime informuese me mësime mësuesit e shkollave tona, ku në bashkëbisedim me grupin punues për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit Komunal, u prezantua strategjia dhe prioritetet e shkollave që do të implementohen gjatë viteve 2024 - 2027. Ky dokument strategjik është një udhërrëfyes për mënyrën se si duam të edukojmë brezat e rinj dhe për nivelin që duam të arrijmë në të ardhmen e afërt. Është gjithmonë i bazuar në kërkesat e domosdoshme të shkollave dhe kohës, duke u krahasuar me nivelet regjionale dhe evropiane.
- Super Finalja e Garës së Robotikës KML Open 2024/25!

Komuna e Deçanit u përfaqësua nga dy ekipet e shkollave “Drita” dhe “Dëshmorët e Baballoqit” në garat republikane të robotikës.

Ekipi “RoboGenius” me mentore Albulena Mataj dhe me nxënësit Blin Avdiu, Blina Jasiqi, Esma Hasanaj dhe Mentor Tafilaj si dhe ekipi “Eksploruesit e vegjël” me mentore Cyme Mataj dhe me nxënësit Rajana Gjocaj, Diar Gjocaj, Khalid Sinanaj dhe Dea Selmonaj, janë dy ekipet në top 100 ekipet me pikët maksimale nga 439 ekipe gjithsej.

- Vizita të vazhdueshme në shkolla monitoruese dhe mentoruese në prag të përfundimit të procesit mësimorë.
- U Mbajt Debati Publik për Projekt – Buxhetin 2025/27 – Granti për Arsim.
U kryesua nga Kryesuesi, z.Hajdar Sutaj, te pranishme ishin drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Dafina Cacaj, drejtori për Arsim, z. Besnik Hulaj, drejtorët e shkollave, zyrtar komunal.
Drejtoresha Cacaj shpalosi para të pranishmëve se si është planifikuar të bëhet ndarja e buxhetit për sektorin e Arsimit, ajo dha sqarimet e nevojshme sa i përket kësaj çështje.
Drejtorët e shkollave paraqiten kërkesat dhe nevojat e tyre për projekt buxhetin e vitit 2025/2027
Pati diskutime të vogla, pyetje dhe sugjerime nga Drejtorët e shkollave të cilve ju përgjigje drejtori Hulaj si dhe drejtoresha Cacaj, më shumë në vija të përgjithshme se çka nevojitet të punohet e të investohet më shumë në shkolla.
- Njoftim nga Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë
Të nderuar nxënës, prindër dhe mësimdhënës,
Ju njoftojmë se nesër, më datë 8 janar 2025 (e mërkurë), sipas kalendarit të MASHT-it, fillon gjysmëvjetori i dytë i vitit shkollor 2024-2025.
Me këtë rast, ftojme të gjithë nxënësit të rikthehen në shkollë me motivim dhe dëshirë për të mësuar. Po ashtu, inkurajojmë mësimdhënësit dhe prindërit që të vazhdojnë të jenë mbështetës të palodhshëm në rrugëtimin e tyre drejt dijes.
Për një gjysmëvjetor të suksesshëm, plot arritje dhe përparim, ju ftojme të bashkëpunojmë dhe të përqendrohemi në përmirësimin e vazhdueshëm, duke sjellë energji pozitive dhe përkushtim në çdo hap.
Suksese të gjithëve! Le ta fillojmë këtë gjysmëvjetor me guxim, besim dhe përkushtim për të arritur më të mirën.
Rikthim të mbarë për nxënësit dhe mësimdhënësit tanë të përkushtuar!
Me respekt:
Besnik Hulaj - Drejtor i DKA-së
- Takim pune me drejtorët e shkollave
Drejtorët e shkollave u pritën nga Drejtori i DKA-së, z. Besnik Hulaj, në një takim pune ku u trajtuan tema të rëndësishme për mirëmenaxhimin e procesit mësimor. Në fokus të diskutimit ishin:

- Përfundimi i gjysmëvjetorit të parë dhe fillimi i mbarë i gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2024/2025.

- Procesi i vlerësimit të mësimdhënësve, si një element kyç për rritjen e cilësisë në arsim.

- Sfida e gripit sezonal dhe masat e ndërmarra për menaxhimin e situatës.

Gjatë takimit, drejtorët prezantuan analizat e suksesit për gjysmëvjetorin e parë dhe raportuan mbi mbarëvajtjen e procesit në fillimin e gjysmëvjetorit të dytë.

Drejtori Hulaj vlerësoi përkushtimin e drejtorëve për menaxhimin efektiv të situatave sfiduese, veçanërisht në lidhje me gripin sezonal. Ai theksoi rëndësinë e përgatitjes dhe koordinimit të mirë për të siguruar një proces mësimor cilësor dhe të sigurt për nxënësit dhe mësimdhënësit.

Një tjetër pikë e rëndësishme e diskutimit ishte zhvillimi profesional i vazhdueshëm i mësimdhënësve, duke theksuar rëndësinë e organizimit të trajnimeve që adresojnë nevojat dhe interesat e tyre.

Drejtori Hulaj përmbylli takimin duke shprehur mirënjohjen për përkushtimin dhe punën e palodhur të stafit të shkollave, duke nënvizuar se bashkëpunimi dhe puna e mirë nuk kanë të ndalur.

- Rezultatet nga Gara Komunale e Fizikes 2025

Komisioni Komunal nxori rezultatet e nxënësve fitues nga Gara Komunale e mbajtur me datën 18.01.2025, të cilët do ta përfaqësojnë Komunën e Deçanit në Garën Shtetërore, të cilat mbahen me datën 01.02.2025, në Departmentin e Fizikës në FSHMN në Prishtinë me fillim në ora 11:00.

Nxënësit fitues janë:

1. Egzon Idrizaj Gjinnazi "Vëllezërit Frashëri" klasa XII
2. Korab Berisha Gjinnazi "Vëllezërit Frashëri" klasa XII
3. Arsa Bajraktari Gjinnazi "Vëllezërit Frashëri" klasa XI
4. Raze Tolaj Gjinnazi "Vëllezërit Frashëri" klasa XI
5. Art Qorraj Gjinnazi "Vëllezërit Frashëri" klasa X
6. Diellza Hulaj Gjinnazi "Vëllezërit Frashëri" klasa X
7. Erdi Shabanhaxhaj Gjinnazi "Vëllezërit Frashëri" klasa X
8. Enkela Zeqiraj SHFMU "Lidhja e Prizrenit" klasa IX
9. Rubina Binakaj SHFMU "Lidhja e Prizrenit" klasa IX

Suksese nxënësve fitues!

Me respekt,

Kryetari i Komisionit Prof Ramë Dobraj

- Dekani i FIM Prof. Dr. Mirlind Bruqi dhe stafi i tij nënshkruan Memorandumin e bashkëpunimit me IAAP "Tafil Kasumaj", në Deçan, Drejtori Lan Stojkaj dhe Prof.Enver Osdautaj!

Marrëveshja përfshinë:

- promovimin e ofertës së FIM për Mekatronikë, Energji të ri-përtitshme, Automjete Motorike, Mekanikë, etj,
- Përkrahje e FIM për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit të IAAP, për shkathtësi praktike në laboratorët e FIM,
- Pjesëmarrja në projekte të përbashkëta,
- Shfytëzimin e ndërsjellë i laboratoreve të institucioneve,
- Mundësinë për zhvillimin e shkathtësive praktike për nxënësit e IAAP dhe vizita të ndërsjella,

- **REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË GARAVE TË XXVI SHTETËRORE NË FIZIKË 2025**

Lajm i mirë për Deçanin!

Me krenari urojmë nxënësit e shkëlqyer të klasës së X-të dhe XII-të të Gjimnazit "Vëllezërit Frashëri", Art H. Qorraj, për arritjen e tij të jashtëzakonshme në garat shtetërore të fizikës, duke zënë vendin e dytë në nivel republike. Po ashtu, në vendin e tretë u radhitën nxënësit Egzon Idrizaj dhe Korab Berisha nga klasa e XII-të.

Ky sukses është një dëshmi e përkushtimit, talentit dhe punës së palodhur të Artit, Egzonit dhe Korabit, të cilët treguan aftësi të jashtëzakonshme në këtë fushë kaq sfiduese. Tani, nxënësit tanë do të përfaqësojnë Deçanin në garat për Olimpiadën Kosovare të Fizikës 2025, duke qenë një shembull frymëzimi për të gjithë nxënësit dhe të rinjtë tanë, garë kjo kualifikuese për garat Evropiane.

Përgëzojmë edhe profesorin e Gjimnazit, z. Ramë Dobraj, për punën dhe angazhimin e tij të palodhur.

Jemi të bindur se do të përfaqësoni denjësisht Deçanin dhe do të na bëni edhe më tutje krenarë!

Suksese!

- Vizita në shkollë nga Ekipa Mbeshtetëse Psikologjike – Pedagogjike në shkollë.
- Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar të Arsimit "Didacta 2025" në Stuttgart, Gjermani

Me një delegacion nga Komuna e Deçanit, i përbërë nga Hajdar Sutaj, kryesues i Asamblesë Komunale në Deçan, Besnik Hulaj, drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit, dhe Afrim Balaj, zëvendës drejtor i ShFMU "Lidhja e Prizrenit" në Deçan, morëm pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Arsimit "Didacta 2025" që po mbahet në Stuttgart, Gjermani.

Ky panair, si një nga ngjarjet më të rëndësishme në Evropë për sektorin e edukimit, ofron një platformë të shkëlqyer për të eksploruar zhvillimet e fundit në arsim, duke përfshirë teknologjinë në edukim, metodat inovative të mësimdhënies dhe mundësitë për bashkëpunime ndërkombëtare.

Gjatë pjesëmarrjes në këtë panair, patëm mundësinë të takojmë dhe të diskutojmë me shumë personalitete nga fusha e arsimit, me theks të veçantë në ekipet që punojnë me teknologjinë arsimore. Kjo ishte një mundësi e mirë për të shkëmbyer përvoja dhe ide për

bashkëpunimin e Komunës së Deçanit me organizata të ndryshme që kontribuojnë në zhvillimin e arsimit.

Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues nga komuna të tjera si Peja, Klina, Prizreni, Suhareka, Zveçanit dhe të tjera, duke e bërë këtë ngjarje një hapësirë të rëndësishme për ndërtimin e rrjeteve dhe bashkëpunimeve mes institucioneve arsimore dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Panairi Didacta 2025 ofron një pasqyrë të gjerë mbi trendet e reja në arsim, platformat digjitale dhe qasjet inovative në mësimdhënie. Pjesëmarrja jonë në këtë panair ka për qëllim të sjellë ide të reja dhe të kontribuojë në zhvillimin e sistemit arsimor në Komunën e Deçanit.

Ky është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe përgatitjes së brezave të rinj për sfidat e së ardhmes. Falënderojmë organizatorët dhe të gjithë ata që kontribuan në realizimin e kësaj eksperience të vlefshme.

Një falënderim i veçantë i dedikohet Kryetarit të Komunës së Deçanit, z. Bashkim Ramosaj, për mbështetjen dhe përkrahjen e tij të pazhvlerë në zhvillimin e arsimit dhe në përfaqësimin dinjitoz të komunës sonë në këtë panair ndërkombëtar. Mbështetja e tij është një shtysë e rëndësishme për avancimin e sistemit arsimor dhe për krijimin e mundësive të reja për mësimdhënësit dhe nxënësit tanë.

- U çertifikuan 74 mësimdhënës

Në ambientet e Qendrës Rinore "Heroina Fitnete Ramosaj", në një solemnitet, u ndanë certifikata për 74 mësimdhënës deçanas, të cilët përfunduan me sukses trajnimet për "Shprehitë për Adoleshencën" - Grupi i tretë, të mbajtura nga Organizata "Lions Quest Kosovo", si dhe trajnimin për Zbatimin e Kurrikulës së Re, të organizuar nga DKA dhe mbështetur nga MASHTI.

Çertifikatat i ndanë Kryetari z. Bashkim Ramosaj, Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, Presidenti i Organizatës "Lions Quest Kosovo" z. Bekim Shoshi, Dr.sc. Hysen Balaj - trajner, Msc. Hamid Qorraj - kryetrajner komunal, znj. Arta Bytyçi - trajnere, znj. Fatlinda Kastrati - trajnere, Zyrtari dhe koordinatori komunal z. Zeqë Malaj,

DKA, falënderon Kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj për përkrahjen e vazhdueshme në ofrimin e kushteve në ngjarje të rëndësishme për arsimin deçanas.

- Komuna e Deçanit i bashkohet aktiviteteve të Kodimit!

Sot, nxënësit e klasës së 4 nga shkolla "Dëshmorët e Baballoqit" në Deçan, së bashku me mësuesen e tyre, Cyme Mataj, u angazhuan në një aktivitet të veçantë të kodimit në CODE.ORG

Gjatë aktivitetit, ata mësuan për krijimin e Sprites, duke shfaqur kreativitetin e tyre në krijimin dhe animimin e karaktereve të ndryshme.

Ky aktivitet është një hap drejt të ardhmes digjitale dhe një mundësi fantastike për nxënësit që të mësojnë bazat e programimit në një mënyrë argëtuese dhe edukative.

- Takim pune me Drejtorët e Institucioneve Arsimore në Deçan

Sot u mbajt një takim pune me Drejtorët e Institucioneve Arsimore në Deçan, ku u diskutuan çështje të rëndësishme që lidhen me zhvillimin e arsimit në komunën tonë. Takimin e hapi Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Besnik Hulaj, i cili theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe për të krijuar kushte më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Gjatë takimit u trajtuan tema të ndryshme që prekin drejtpërdrejt punën dhe sfidat e institucioneve arsimore në Deçan. Një nga pikat kryesore ishte përmirësimi i procesit edukativo-arsimor, ku u diskutuan strategjitë për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe për të adresuar sfidat e përditshme në shkolla.

Një tjetër temë e rëndësishme ishte trajnimi i mësimdhënësve, duke u fokusuar në nevojën për zhvillim profesional të vazhdueshëm me qëllim rritjen e cilësisë së punës mësimore. U theksua se investimi në trajnime është i domosdoshëm për të siguruar që mësimdhënësit të jenë të përgatitur për të përdorur metoda bashkëkohore në procesin mësimor.

Gjithashtu, një pjesë e takimit iu kushtua organizimit të festës së Pavarësisë së Kosovës, duke diskutuar mënyrat më të mira për të shënuar këtë ditë të rëndësishme me aktivitete që përfshijnë nxënësit dhe mësimdhënësit në mënyrë dinjitoze dhe festive.

Ky takim ishte një mundësi e mirë për shkëmbimin e ideve dhe diskutimin e hapur mbi sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e arsimit në Deçan. Bashkëpunimi dhe angazhimi i përbashkët mbeten çelësi për krijimin e një sistemi arsimor më cilësor dhe më efikas.

- Më 14 Shkurt, me fillim nga ora 10:00, në prag të 17 Shkurtit, përvjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, u shfaq program i veçantë i përgatitur nga nxënësit e IAAP "Tafil Kasumaj" në Deçan, nxënësit përformuan në Sallën e Asamblesë Komunale në Deçan! Ky program është një mundësi për të shënuar këtë datë të rëndësishme dhe për të përkujtuar sakrificat e bëra për lirinë dhe pavarësinë tonë.

- Në ambientet e NPL "Higjiena" u pritën për vizitë nxënësit e klasës së tretë së bashku me mësuesën e tyre Albulena Mataj nga Shkolla Filllore e Mesme Ulët "Drita" në Gramaçel! Bashkë diskutuan për menaxhimin e mbeturinave, të cilët u njoftuan për së afërmi me punën që bën kompania "Higjiena" dhe në fund ata me rastin e muajt Tetor, muaj i ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit për koleget tona shpërndan nga një dhuratë simbolike!

- Testi PISA në IAAP "Tafil Kasumaj"
Në ambientet e IAAP "Tafil Kasumaj", u zhvillua pjesa e parë e pilot Testit PISA me nxënës të gjeneratës së vitit 2008. U përzgjedhën 83 nxënës nga shkolla "Tafil Kasumaj". Për mbarëvajtjen e testit u kujdes koordinatori, profesoresha Fatime Kukalaj, ndërsa për mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike dhe funksionimin e internetit u kujdes specialisti i IT-së, Remzi Dautaj.
Gjatë zhvillimit të testit, nxënësit i vizitoi drejtori i DKA-së, z. Besnik Hulaj, i cili u uroi sukses nxënësve dhe falënderoi akterët e përfshirë në këtë proces për angazhimin e tyre të palodhur.

- Njoftim për sukses tjetër të nxënës tonë!

Njoftojmë për një tjetër sukses të nxënës Erza Imeraj, nga klasa XI e shkollës IAAP “Tafil Kasumaj” në Deçan.

Pas arritjeve të saj në Olimpiadën e Matematikës, Erza ka shënuar një tjetër rezultat të shkëlqyer në testin përzgjedhës (TST) për Olimpiadën Evropiane të Vajzave në Matematikë (EGMO), duke u renditur e teta në nivel vendi. Si rezultat, më 8 mars 2025, ajo do të marrë pjesë në fazën e dytë të testimit (TST-II). I urojmë Erzës shumë suksese në garën e radhës!

- Garat Komunale në Hendboll – Deçan 2024

Në organizim të Shoqatës së Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit në Deçan, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe me mbështetjen e Zyrës së Kryetarit, z. Bashkim Ramosaj, u zhvilluan garat komunale në hendboll për të dy gjinitë.

Kategoria e vajzave

Në këtë kategori morën pjesë ekipet e pesë shkollave. Fitueset e garave ishin:

Vendi i parë – Shkolla “Bajram Curri”, Strelle i Epërm

Vendi i dytë – Shkolla “Dëshmorët e Vokshit”, Pobërgjë

Vendi i tretë – Shkolla “Dëshmorët e Baballoqit”, Baballoq

Kategoria e djemve

Në këtë kategori garuan ekipet e dhjetë shkollave, ku fitues ishin:

Vendi i parë – Shkolla “Maxhun Çekaj”, Irzniq

Vendi i dytë – Shkolla “Lidhja e Prizrenit”, Deçan

Vendi i tretë – Shkolla “Heronjtë e Dukagjinit”, Gllogjan

Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor – Deçan, së bashku me DKA-në, falënderon të gjitha shkollat pjesëmarrëse dhe ekipet fituese. Ju urojmë suksese në garat e ardhshme!

- Urimi i drejtorit të DKA-së z. Besnik Hulaj me rastin e festës 7 Marsi, Ditës së Mësuesit,

Të nderuar dhe të respektuar mësues e mësuese, kudo që jetoni dhe punoni,
Me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, ju përcjellim urimet më të përzemërta për këtë festë të shenjtë. Kjo ditë është një mundësi për të shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin tonë të thellë për punën tuaj të palodhur, përkushtimin dhe sakrificën që bëni çdo ditë në misionin fisnik të edukimit.

Falë përpjekjeve tuaja, gjuha jonë shqipe dhe vlerat kombëtare trashëgohen të pastra tek brezat e rinj. Ju jeni drita që ndriçon rrugën e dijes dhe shpresa e së ardhmes sonë.

Me respekt e mirënjohje të thellë, ju uroj shëndet, jetë të gjatë dhe suksese të vazhdueshme në këtë mision kaq të rëndësishëm. Le të mbetet 7 Marsi gjithmonë një ditë krenarie dhe nderimi për ju.

Gëzuar Festën e Mësuesit!

Stafi i DKA-së

Drejtori i DKA-së

Besnik Hulaj

- Me rastin e 7 Marsit - Ditës së Mësuesit, Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj, me Drejtorinë e Arsimit, ndamë mirënjohje për mësimdhënësit e pensionuar nga 7 Marsi i vitit 2024 deri sot.
Të dashur mësues, këto mirënjohje janë për të kuptuar se jeni me vlera të larta, ne do të jemi mirënjohës për gjithë jetën, për kontributin tuaj ndër dekada për fëmijët tanë edhe për ne.
7 Marsi është burim frymëzimi për edukimin e popullit gjeneratë pas gjenerate dhe i tillë do të mbetet gjithmonë, sepse janë pikërisht shkollat tona ato që nxorren dijetarë, mësues e luftëtarë të lirisë.
Të gjithë veteranëve të arsimit, mësuesve, drejtuesve të institucioneve arsimore, urime 7 Marsi, urime dita juaj!
- U mbajt gara Komunale e Olimpiadës së Përbashkët e Gjuhës Shqipe e mbi 300 nxënësve të klasave të 9-ta, nga 18 shkolla në Komunën tonë, që treguan aftësitë e tyre gjuhësore në Olimpiadën e Përbashkët të Gjuhës Shqipe Shqipëri - Kosovë, të garës së Gjuhës Shqipe në nivel shkolle, faza e parë e testit.
- Krosi "Rruga e Lirisë" në Glllogjan – Kujtim dhe Nderim për Epopenë e Dukagjinit
Sot në Glllogjan u mbajt krosi tradicional "Rruga e Lirisë", një aktivitet i organizuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Komunës, z. Bashkim Ramosaj, OVL- UÇK Deçan, duke shënuar fillimin e aktiviteteve për Epopenë e Dukagjinit, 24 Marsin.
Përveç garës sportive, nxënësit e SHFMU "Heronjë e Dukagjinit" në Glllogjan dhe SHFMU "Shtjefën Kurti" nga Novosella e Epërme, Komuna e Gjakovës, organizuan aktivitete kulturore për të përkujtuar sakrificën dhe qëndresën e heronjve tanë.
Një falënderim i veçantë për QKMF "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan, Policinë e Kosovës, si dhe të gjithë drejtorët dhe mësimdhënësit që kontribuan në realizimin e këtij organizimi të mrekullueshëm. Po ashtu, falenderojmë Zyrtarët e Kompleksit Memorial të Dëshmorëve të Kombit në Glllogjan për përkujdesjen e tyre gjatë këtij aktiviteti!
Lavdi gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit, atyre që sakrifkuan jetën e tyre për idealin më të shenjtë, lirinë e atdheut. Në çdo pranverë, kur lulëzojnë lulëkuqet mbi tokën e larë me gjakun e tyre, kujtimi i tyre bëhet edhe më i gjallë në zemrat tona. Sakrifika e tyre nuk është harruar, por jeton në çdo frymëmarrje të lirë, në çdo hap që hedhim në një atdhe të pavarur. Ne sot gëzojmë dritën e kësaj lirie, falë atyre që nuk e kursyen as jetën, as më të dashurit e tyre. Lavdi e përjetshme heronjve të kombit!
- Rezultatet e testit nga Faza e Dytë e Olimpiadës së Përbashkët të Gjuhës Shqipe Shqipëri – Kosovë
Komisioni Komunal Vlerësues ka publikuar rezultatet e testit nga Faza e Dytë e Olimpiadës së Përbashkët të Gjuhës Shqipe Shqipëri – Kosovë.
Nxënësit që do të përfaqësojnë komunën tonë në Fazën e Tretë të OPGjSh, në nivel vendi, janë:
1. Ema Kameraj – SHFMU "Isa Boletini", Isniq
2. Elda Lokaj – SHFMU "Dëshmorët e Vokshit", Pobërgjë

3. Agon Muqaj – SHFMU “Kuvendi i Verrave të Llukës”, Llukë e Epërme
Faza e Tretë e Olimpiadës së Përbashkët të Gjuhës Shqipe Shqipëri – Kosovë do të zhvillohet më 27.03.2025.

Suksese nxënësve në këtë sfidë të rëndësishme!

- U shenua Dita Nderkombëtare e Sindromes Down në të gjitha shkollat e komunës sonë me aktivitete të ndryshme.
- Garat Komunale në Volejboll mes ekipeve të shkollave tona në Deçan
Nën organizimin e Shoqatës së Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit në Deçan, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe me mbështetjen e Zyrës së Kryetarit, Bashkim Ramosaj, u zhvilluan garat komunale në volejboll për të dyja gjinitë.
Në kategorinë e vajzave morën pjesë ekipet e njëmbëdhjetë shkollave. Fitueset e kësaj gare ishin:
 - Vendi i parë: Shkolla “Lidhja e Prizrenit” – Deçan
 - Vendi i dytë: Shkolla “Rexhep Kadriaj” – Rastavicë
 - Vendi i tretë: Shkolla “Bajram Curri” – Strelc i EpërmNë kategorinë e djemve, gjithashtu garuan ekipet e njëmbëdhjetë shkollave. Fituesit ishin:
 - Vendi i parë: Shkolla “Maxhun Çekaj” – Irzniq
 - Vendi i dytë: Shkolla “Lidhja e Prizrenit” – Deçan
 - Vendi i tretë: Shkolla “Dëshmorët e Vokshit” – PobërgjëShoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor – Deçan, së bashku me DKA-në, falënderon të gjitha shkollat pjesëmarrëse dhe ekipet fituese. Ju urojmë suksese në garat e ardhshme!
- Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj bashkë me bashkëpunëtorë, zhvilloj një takim pune me drejtorët e shkollave, ku u diskutua për planifikimin e aktiviteteve në prag të festave të Majit dhe Ditës së Çlirimit të Deçanit.
Gjatë takimit, u shqyrtuan edhe sfidat e hasura gjatë zhvillimit të procesit mësimor, si dhe temat me rëndësi për përmirësimin e cilësisë në arsim. Drejtorët ndanë përvojat e tyre dhe propozuan masa konkrete për adresimin e vështirësive, me qëllim krijimin e një mjedisi më të mirë për nxënësit dhe mësimdhënësit.
- Nxënësit Tanë Shkëlqejnë në Olimpiadën e Përbashkët të Gjuhës Shqipe!
Me krenari ju njoftojmë se nxënësit tanë kanë arritur rezultate të shkëlqyera në Olimpiadën e Përbashkët të Gjuhës Shqipe për klasat e nënta në nivel vendi.
Në këtë garë të rëndësishme, Elda Lokaj nga shkolla “Dëshmorët e Vokshit”, Pobërgjë, dhe Agon Muqaj nga shkolla “Kuvendi i Verrave të Llukës”, Llukë e Epërme, janë përzgjedhur ndër 39 nxënësit më të mirë për të përfaqësuar shkollat e tyre në Olimpiadën Kombëtare që do të mbahet më 10 Prill 2025 në Tiranë.
Kjo arritje është dëshmi e punës së mësimdhënësve të tyre të palodhur dhe përkushtimit ndaj gjuhës sonë të bukur.
Urime për Eldën dhe Agonin!
Ju urojmë suksese në sfidën e radhës dhe jemi të sigurt se do të na bëni edhe më krenarë!

- Njoftim zyrtar për pushimet pranverore – DKA - Deçan
Drejtoria Komunale e Arsimit – Deçan njofton se, bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 04/2024 për Kalendarin Shkollor 2024/25, pushimet pranverore për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën e Deçanit do të fillojnë më 07 prill 2025 (e hënë) dhe do të përfundojnë më 11 prill 2025 (e premte).
Mësimi do të rifillojë më 14 prill 2025 (e hënë), sipas orarit të rregullt mësimor.
Ky njoftim vlen për të gjitha institucionet arsimore publike të komunës dhe zbatohet në përputhje të plotë me dispozitat e kalendarit shkollor të miratuar nga MASHTI.
- Nxënësja Erza Imeraj përfaqëson Kosovën në Olimpiadën Evropiane të Matematikës për Vajza (EGMO 2025)
Nxënësja Erza Imeraj nga IAAP “Tafil Kasumaj” në Deçan, është përzgjedhur si anëtare e ekipit kombëtar të Kosovës dhe po merr pjesë në Olimpiadën Evropiane të Matematikës për Vajza (EGMO), e cila po zhvillohet në periudhën 11–17 prill 2025.
Në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare marrin pjesë mbi 60 shtete, përfshirë edhe vende jashtë Evropës me status të veçantë mysafiri.
I urojmë nxënësës Erza Imeraj shumë sukses dhe përfaqësim të denjë të Republikës së Kosovës!
- Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj bashkë me nënkryetarin e Komunës, Sami Cacaj dhe drejtorin e Arsimit z. Besnik Hulaj, vizituan shkollën fillore “Lan Selimi” në Lumbardh, ku pas përfundimit të ndërtimit të objektit të ri, tashmë po shkohet drejt përfundimit punimet për rregullimin e oborrit dhe ndërtimin e rrethojës së shkollës.
Po ashtu, vizituan shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit” në Deçan, ku janë duke vazhduar punimet për ndërtimin e objektit të ri të shkollës dhe çerdhes publike, një investim shumë i rëndësishëm për fëmijët dhe familjet tona.
- Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj priti në takim djemtë e shkollës fillore “Maxhun Çekaj” nga Irzniqi, të cilët gjatë vitit shkollor 2024/25 kanë arritur suksese të jashtëzakonshme në gara sportive, duke na bërë krenarë të gjithëve.
Në garat komunale, ata fituan vendin e parë në ping pong, futboll, volejboll dhe hendboll. Nuk u ndalën me kaq, duke triumfuar edhe në garat regjionale ku arritën të zënë vendin e parë në ping pong, volejboll dhe hendboll.
Krenaria më e madhe erdhi në nivel republikan, ku ekipi i volejbollit doli kampion, duke përfaqësuar jo vetëm shkollën dhe komunën tonë, por edhe gjithë regjionin me dinjitet dhe sukses.
Urime këtyre të rinjve të talentuar për rezultatet mbresëlënëse! Falënderim i veçantë për mësimdhënësit dhe stafin e shkollës për përkrahjen dhe përkushtimin e vazhdueshëm. Komuna e Deçanit është krenare me ju.
- Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj bashkë me kolegë, realizoj vizitë pune në SHFMU “Lidhja e Prizrenit” në Deçan, ku u njoftuan nga afër me ecurinë e punimeve në objektin e ri të shkollës.
Ky objekt modern do të jetë një ndër më të mirët në Komunën e Deçanit dhe do të ofrojë kushte të shkëlqyera për zhvillimin e procesit mësimor për nxënësit e qytetit tonë. Punimet

po zhvillohen me profesionalizëm dhe kujdes nga kompania ndërtimore EURO-ING, duke respektuar standardet më të larta të ndërtimit.

Projekti pritet të përfundojë brenda një periudhe të shkurtër kohore, duke i dhënë arsimit në Deçan një hapësirë të re, funksionale dhe moderne.

Falënderojmë Kryetarin e Komunës së Deçanit, z. Bashkim Ramosaj, Ministrinë e Arsimit, kompaninë EURO-ING, si dhe Drejtorinë e shkollës dhe gjithë stafin (arsimor e teknik) për përkushtimin dhe kujdesin e treguar ndaj nxënësve gjatë periudhës së ndërtimit të shkollës.

- 1 Qershori në Deçan, Festa Ndërkombëtare e Fëmijëve dhe Festa e Abetares!
Ashtu siç ishte planifikuar dhe tashmë është bërë traditë në komunën e Deçanit, u organizua festa e 1 Qershorit, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, njëkohësisht edhe Festa e Abetares. Në këtë ngjarje madhështore morën pjesë 22 shkolla fillore të mesme të ulëta, përfshirë edhe paralelet e ndara të komunës, me mbi 400 nxënës që performuan me përkushtim dhe kreativitet. Të pranishëm në këtë festë ishte edhe Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj bashkë me drejtorë të drejtorive komunale dhe qytetarë të shumtë, të cilët na nderuan me pjesëmarrjen dhe mbështetjen e tyre.
Faleminderit secilit që u bë pjesë e kësaj feste të bukur dhe që kontribuo në realizimin e saj me sukses.
- Bazuar në planin dinamik të punës së DKA-së dhe në kuadër të parapërgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2025/2026, sot Drejtori i DKA-së, z. Besnik Hulaj, zhvilloi një takim pune me drejtorët e shkollave të komunës sonë, me këtë rend dite:
Rendi i ditës:
 1. Përfundimi i gjysmëvjetorit të dytë dhe vlerësimi i nxënësve;
 2. Riprovimet dhe mësimi plotësues;
 3. Përgatitjet për Testin e Maturës Shtetërore – regjistrimi i nxënësve në platformën e-Kosova;
 4. Përgatitjet për Testin e Arritshmërisë;
 5. Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë për vitin shkollor 2025/2026 – sfidat dhe qasja;
 6. Përgatitjet për regjistrimin e nxënësve në klasat e dhjeta – pritshmëritë;
 7. Kërkesë me rëndësi të veçantë: sistematizimi i mësimdhënësve në lëndët profesionale (normativi);
 8. Deklarimi i vendeve të lira për secilën shkollë;
 9. Të ndryshme.

Në përmbyllje, Drejtori i DKA-së theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet drejtorive të shkollave dhe DKA-së në realizimin me sukses të detyrave dhe obligimeve të parapara. U kërkuar angazhim maksimal në zbatimin e përgatitjeve për përmbylljen e vitit aktual shkollor si dhe për fillimin sa më të mbarë të vitit të ri shkollor 2025/2026, me qëllim të sigurimit të një procesi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit.
- Sukses i jashtëzakonshëm - Nxënësi Atlant Dobraj ndër më të mirët në Kosovë në garën “Kangaroo”
Nga mbi 2,000 nxënës pjesëmarrës në Garën Ndërkombëtare të Matematikës “Kangaroo 2025”, që organizohet në mbarë botën dhe në Kosovë, Atlant Dobraj, nxënësi i klasës së 4-të

në shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit” – Deçan, është përzgjedhur ndër më të suksesshmit në nivel vendi, me rezultat prej 71 pikësh (73.96%) në kategorinë e tij. Për këtë arritje të jashtëzakonshme, Atlant është çertifikuar nga Instituti ATOMI në bashkëpunim me Kangaroo Kosova, duke na bërë të gjithëve krenarë për punën, talentin dhe përkushtimin e tij.

- Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit në Deçan, u mbajt një takim informues me qëllim të përgatitjes së Testit të Maturës Shtetërore. Gjatë këtij takimi u caktuan administruesit që do të angazhohen të shtunën, më 21 qershor 2025, në komunën e Pejës, në katër qendra të testimit.

Komuna e Deçanit vazhdon të dëshmojë përkushtimin e saj për një proces të rregullt, të drejtë dhe transparent të maturës, duke bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe me të gjitha institucionet relevante. Ky bashkëpunim i ngushtë është tregues i angazhimit të përbashkët për të garantuar suksesin e nxënësve dhe integritetin e sistemit arsimor.

Drejtoria e Arsimit në Deçan falënderon të gjithë të përfshirët për gatishmërinë dhe përkushtimin në këtë proces të rëndësishëm dhe fton administruesit e caktuar që të jenë në nivelin më të lartë të përgjegjësisë gjatë ditës së testimit.

Maturantëve tanë ju urojmë shumë suksese në këtë hap të rëndësishëm të rrugëtimit të tyre arsimor dhe jetësor!

- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), ka organizuar me sukses pjesën e parë të Provimit të Maturës Shtetërore, duke vlerësuar lart organizimin dhe administrimin e këtij procesi të rëndësishëm arsimor.

Provimi është mbajtur në dy qendra testimi, ku maturantët janë sistemuar në 19 salla. Testi ka filluar në kohë dhe nuk është evidentuar ndonjë parregullsi e theksuar.

Megjithatë, për shkak të përdorimit të telefonit gjatë testit, një nxënës është përjashtuar nga procesi i testimit.

DKA falënderon të gjithë aktet e përfshirë në organizimin dhe mbarëvajtjen e Provimit të Maturës Shtetërore. Një falënderim i veçantë u drejtohet: policëve kujdestarë nga Stacioni Policor i Deçanit, drejtorëve të shkollave, koordinatorëve të qendrave të testimit, administruesve nga Komuna e Pejës, si dhe vetë maturantëve tanë, të cilët dëshmuar një nivel të lartë përgjegjësie dhe kulturë qytetare.

- Urimi i drejtorit të DKA-së z. Besnik Hulaj, drejtuar nxënësve me rastin e përfundimit të vitit shkollor 2024/2025

Me përfundimin e këtij viti shkollor, dëshiroj t'ju shpreh urimet më të përzemërta për gjithë përpjekjen, përkushtimin dhe arritjet që keni shënuar gjatë këtij rrugëtimi të dijes. Ju faleminderit për energjinë dhe gjallërinë që i keni dhënë shkollave tona,

Jeni frymëzimi dhe arsyeja jonë për të vazhduar me përkushtim rrugën e edukimit.

Tani që ka ardhur koha për pushime, ju uroj ditë të bukura, të mbushura me qetësi, lojë dhe kohë cilësore me familjen e miqtë tuaj. E meritoni një pushim të mbarë pas gjithë punës suaj.

Një urim i veçantë shkon për ju, të dashur maturantë, që përfunduat një kapitull të rëndësishëm të jetës tuaj dhe po hapni dyert e një të ardhmeje të re.

Ju uroj nga zemra shumë sukses në studimet e më tutjeshme, në rrugën e jetës dhe në ndërtimin e ëndrrave tuaja.

Besoni në vetvete, sepse keni potencialin të arrini lartësitë që dëshironi.

Me respekt dhe përzemërsi,

Drejtori i DKA-së

Besnik Hulaj

- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA-në), ka organizuar Testin e Arritshmërisë për klasat e nënta, i cili është mbajtur në 3 qendra të testimit në SHFMU "Lidhja e Prizrenit", ku nxënësit janë sistemuar në 13 salla testimi. Në këtë proces kanë marrë pjesë 370 nxënës nga shkollat e komunës sonë, testi ka filluar me kohë dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi. DKA falënderon të gjithë akterët e përfshirë në organizimin dhe zbatimin e Testit të Arritshmërisë për angazhimin dhe bashkëpunimin e treguar.
- Vizita në shkollat e mesme të komunës sonë
Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj vizitoj Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" dhe IAAP "Tafil Kasumaj", ku pa procesin e regjistrimit të nxënësve në klasat e 10-ta.
U konstatua se gjithçka po zhvillohet në mënyrë të rregullt, transparente dhe me përkushtim të madh nga komisionet përkatëse bazuar në UA.
Falënderim për anëtarët e komisioneve për angazhimin e tyre të palodhshëm, si dhe për drejtorët e shkollave për organizimin shembullor.
- Gjatë muajve Maj dhe Qershor, shkollat janë furnizuar me lëndë drusore dhe pelet për ngrohje për vitin shkollor 2025/2026.



Drejtori:
Besnik Hulaj

Korrik 2025
Deçan